



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

U D H Ë Z I M

Nr. 13, datë, 8 / 10 /2014

P Ë R

PROCEDURAT E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT USHTARAK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; shkronjës “f”, të nenit 13, të Ligjit Nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; pikës 3, të nenit 9, të Ligjit Nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”;

U D H Ë Z O J:

TË PËRGJITHSHME

1. Hyrje

Stadi i ri i forcës tonë ushtarake profesioniste, ndryshimet ligjore, angazhimi për të përafruar gjithë legjislacionin e Forcave tona të Armatosura me ato të vendeve të NATO-s, si dhe vendosja e procedurave standarde të veprimit për menaxhimin efikas të burimeve njerëzore, kanë shtruar nevojën e rishikimit dhe përmirësimit të kontratës së shërbimit për personelin ushtarak.

Kontrata e shërbimit të personelit ushtarak në Forcat e Armatosura si marrëveshje ndërmjet shtetasit shqiptar “ushtarakut/punëmarrësit” dhe MM/SHPFA/Komanda, përfaqësuesit të “Institucionit/Punëdhënësit” shërben për rregullimin e marrëdhënieve individuale të punës si dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella.

Mbështetur në ndryshimet ligjore janë saktësuar të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve për lidhjen e kontratës së shërbimit me synim rritjen e cilësisë të rekrutimit të shtetasve shqiptarë në moshë sa më të reja si dhe motivimin për rritjen e profesionalizmit dhe ecurisë në gradë dhe karrierë.

2. Qëllimi

Qëllimi i udhëzimit është sigurimi i zbatimit të kërkesave ligjore si dhe përcaktimi i kërkesave dhe rregullave për procedurat e standardet e punës që do të zbatohen në lidhjen e kontratës së shërbimit ushtarak aktiv.

3. Fusha e zbatimit

Kërkesat këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e udhëzimit për lidhjen e kontratës së shërbimit janë:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit
- Drejtoria e Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakut
- Shtabi i Përgjithshëm i FA
- Drejtoria e Personelit në SHP(J-1)
- Komandat e Forcave
- Komanda Mbështetëse
- Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes
- Komandat e njërive dhe reparteve
- Qendra e Personel Rekrutimit

II. KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PROCEDURËN E LIDHJES SË KONTRATËS SË SHËRBIMIT.

- a) Ushtaraku me pranimin në shërbimin ushtarak do të lidhë kontratë me Forcat e Armatosura.
- b) Ushtarakët, që nënshkruajnë kontratë, janë të detyruar të shërbejnë në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura, sipas nevojave dhe situatave operationale, brenda dhe jashtë vendit
- c) Kontrata e nënshkruar midis ushtarakut dhe përfaqësuesit ushtarak, të cilit i është dhënë apo deleguar me ligj ky autoritet, nënkupton se lidhet me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
- d) Në emër të Forcave të Armatosura për ushtarët/detarët aktivë dhe për nënoficerët, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe strukturave të varësisë së tij, kontratën e nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.
- e) Kontrata për personelin ushtarak përmban të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në marrëdhëniet e punës, si dhe të drejtat, detyrat dhe kufizimet që rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë specifikën e misionëve dhe detyrave operationale.
- f) Me rekrutë, kandidatë për ushtarë/detarë aktivë për periudhën e trajnimit nënshkruhet kontratë midis Komandantit të Shkollës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale dhe kandidatit për ushtar.
- g) Kontrata do të hartohen sipas kërkesave të kreut IV, të këtij udhëzimi dhe modeleve, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi. (Shtojcat nr. 1, Modeli i kontratës së shërbimit për ushtarakët, dhe Shtojca nr 2, Modeli i kontratës për ndjekjen e studimeve të larta brenda apo jashtë vendit dhe shërbim si oficer aktiv në Forcat e Armatosura)
- h) Kontrata e shërbimit për personelin ushtarak do të lidhet me shkrim në 3 (tre) kopje. Ata administrohen në 2 kopjet e dosjes fizike të personelit. Një kopje e mban vetë personi. Afati maksimal i nënshkrimit dhe dërgimi i kopjes në QPR duhet të jetë jo më vonë se 30 ditë nga data e titullimit dhe emërimit në detyrë.
- i) Në rastet kur ushtaraku ushtar/detar aktiv, titullohet nënoficer, apo oficer kontrata e mëparshme ndërpritet dhe lidhet kontratë e re si nënoficer apo oficer.
- j) Me qëllim mbajtjen dhe ruajtjen sa më gjatë të përvojës së fituar, për të mbajtur më mirë nën kontroll piramidën e gradave dhe për të ulur shpenzimet financiare të panevojshme, rinovimi i kontratës do të bëhet vetëm pas plotësimit të afatit të kontratës fillestare.

Ushtarakët, të cilët pas plotësimit të këtyre afateve, shfaqin performancë më të lartë në kryerjen e detyrave dhe kanë fituar arsimimin dhe kualifikimet përkatëse, do të vazhdojnë ecuarin në gradë dhe karrierë.

- k) Në rast shkeljeje të kontratës, shtetasit dhe ushtarakët detyrohen të dëmshpërblejnë shpenzimet për kohën e studimit apo kualifikimit brenda ose jashtë vendit. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes për shlyerjen e detyrimit në këto raste përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tij ngarkohet shërbimi përmbartimor gjyqësor.
- l) Ndërprerja e kontratës është masa më ekstreme e marrë ndaj ushtarakut. Rastet dhe afatet e zgjidhjes së kontratës së shërbimit do të jenë ato të përcaktuara në legjislacionin shqiptar.

III. PËRMBAJTJA E KONTRATËS SË UNIFIKUAR:

- Identitetin e palëve
- Kategorinë e personelit ushtarak
- Repartin, nënrepartin (vendin e punës)
- Përshkrimin e përgjithshëm të punës
- Datën e fillimit të punës, studimeve
- Kohëzgjatjen në shërbim/studim
- Kohën normale javore të punës
- Kohëzgjatjen e pushimeve të paguara
- Afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës
- Pagën, elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj, shtesat mbi page
- Kompensimet sipas akteve ligjore dhe nënligjore të disiplinuar edhe në Tabelat e Organizimit dhe Pajisjeve
- Siguricioni shoqëror dhe shëndetësor.
- Penalitetet në rast të zgjidhjes së njëanshme të kontratës, etj.

IV. AFATET E KONTRATËS SË SHËRBIMIT PËR USHTAR/DETAR, NËNOFICER DHE OFICER AKTIV:

1. Autoritetet e nënshkrimit dhe afatet e lidhjes së kontratës janë përcaktuar në nenin 9, të ligjit nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".
2. **Ushtarët/detarët**, me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak aktiv, nënshkruajnë kontratë, si më poshtë:
 - a) Kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës është 3-vjeçare, dhe nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59/2014.
 - b) Kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura në Shtabin e Përgjithshëm të FA dhe strukturave të varësisë së tij, kontratën e nënshkruajnë nënshkruan Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, Komandanti i Forcës, Komandanti i Strukturës mbështetëse (apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura).

- c) Shtetasit shqiptar, kandidat për “Ushtar/detar aktiv”, me arsim të lartë, i jepet grada “Ushtar II/detar II” që në momentin e titullimit dhe dhënies së gradës.
3. **Nënoficerët**, me pranimin e tyre në shërbimin ushtarak aktiv, nënshkruajnë kontratën, si më poshtë:
- a) Kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.
 - b) Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës për gradën respektive bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, dhe nuk duhet të kalojë moshën maksimale e përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 59/2014.
 - c) Kontrata nënshkruhet midis ushtarakut dhe Forcave të Armatosura. Në emër të Forcave të Armatosura nënshkruajnë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ose personi i autorizuar prej tij, komandanti i forcës, komandanti i strukturës mbështetëse apo komandantët e strukturave të tjera kryesore, në përputhje me strukturën e Forcave të Armatosura.
 - d) Nënoficerët pas marrjes së gradës “Rreshter”, sipas pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” nuk nënshkruajnë kontratë, por vazhdojnë shërbimin aktiv të karrierës dhe shërbejnë në shërbimin aktiv sipas pikës 1, të po këtij neni. (Moshë maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv)

4. **Studentët ushtarakë dhe oficerët,**

- a) Kontrata për studentët ushtarakë dhe oficerët lidhet me fillimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. Në kontratë përfshihen koha e arsimimit dhe 6 vjet periudhë shërbimi si oficer në Forcat e Armatosura.
- b) Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës për gradën respektive bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të këtij ligji, dhe nuk duhet të kalojë moshën maksimale e përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji;
- c) Në emër të Forcave të Armatosura për studentët ushtarakë nënshkruan komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, ndërsa për oficerët nënshkruan drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.
- d) Oficerët pas marrjes së gradës “Major”, sipas pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” nuk nënshkruajnë kontratë, por vazhdojnë shërbimin aktiv të karrierës dhe shërbejnë në shërbimin aktiv sipas pikës 1, të po këtij neni. (Moshë maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv)
- e) Në rastet e rinovimit të kontratës me oficerët kontrata nënshkruhet nga drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.

V. **KËRKESA TË VEÇANTA**


- a. Me kandidatët për oficerë të rinj që do të kryejnë shkollat e larta ushtarake brenda ose jashtë vendit kontrata nënshkruhet në fillim të studimeve.

- b. Me kandidatët për oficerë të rinj që rekrutohen pas përfundimit të shkollës së lartë, kontrata nënshkruhet në fillim të kursit ushtarak përkatës. Kontrata nënshkruhet nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes dhe drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.
- c. Me ushtarakët që dërgohen jashtë shtetit për ndjekjen e kurseve institucionale apo funksionale, për specializime të ndryshme për llojet e forcave dhe specialitete detare, ajrore, mjekësi, xhenio, kimi, etj, do të lidhet kontratë e veçantë, e cila të përcaktojë detyrimet, të drejtat, afatet, si dhe penalitetet në rast mospërbushjeje të saj. Kontrata nënshkruhet nga drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.
- d. Studenti pas titullimit “oficer aktiv”, dhënies së gradës së parë dhe me emërimin në detyrë, nënshkruan kontratën e shërbimit ushtarak si oficer.
- e. Degët/Seksionet e Personelit në Forca, njësi dhe struktura të tjera janë përgjegjëse për plotësimin e kontratave të shërbimit. Në rastet kur kontrata do rinovohet, ato 1(një) muaj para plotësimit të afatit të kontratës fillestare, përgatisin raportin për titullarin në lidhje me plotësimin e detyrimeve, kualifikimeve të ushtarakut duke pasur të dokumentuar edhe mendimin e tij.
- f. Në marketingun dhe promovimin e FA për rekrutim dhe pranim kandidat për ushtarë/detarë aktivë, strukturat përkatëse duhet të parashikohen masa në lidhje me përmbajtjen e kontratës, të drejtat dhe detyrimet, përfitimet, kompensimet, etj.
- g. Në programet e arsimimit, kualifikimit dhe trajnimit të zhvillohen edhe tema për aspektet ligjore dhe etike, të detyrimeve që kanë ushtarakët ndaj kontratës së unifikuar të shërbimit ushtarak.
- h. Të dhënat e kontratës së ushtarakëve që lidhen me afatin e fillimit dhe të mbarimit të saj, do të pasqyrohen rregullisht në Bazën elektronike të të Dhënave të Personelit.
- i. Autoritetet përgjegjëse, të cilat me ligj kanë autoritetin për të lidhur kontratë, brenda muajit dhjetor 2014, duhet të lidhin kontratën me të gjithë kategoritë e ushtarakëve që aktualisht nuk kanë kontratë në dosjet e tyre personale.
- j. Për oficerët që aktualisht nuk kanë lidhur kontratë dhe kanë vjetërsi në shërbim më pak se 6 vjet, të merren masa për lidhjen e kësaj kontrate.
- k. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve, J1 në Shtabin e Përgjithshëm të FA, të monitorojnë zbatimin e akteve ligjore dhe të kërkesave të këtij udhëzimi për afatet lidhjes së kontratës për ushtarakët e shërbimit aktiv.
- l. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit për studentët që përfundojnë studimet me mesatare mbi 8.5, brenda 2 alternativave që ata kërkojnë të shërbejnë të propozojë emërimin në detyrë në përshtatje me gradën dhe specialitetin.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Komandantët e Forcave, Komandanti i Komandës Mbështetëse, Komandanti i Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes, komandantët e reparteve të varësisë të drejtpërdrejtë, Qendra e Personel Rekrutimit, AISM, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA.
2. Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 1008, datë 22.06.2012, "Politika dhe procedura standarde të veprimit për kontratën e unifikuar të shërbimit për personelin ushtarak. (Modelet e kontratës bashkëlidhur), i ndryshuar, revokohet.
3. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
Struktura -

Adresa : _____ Telefon : _____ ; Fax : _____
Web site : _____ e-mail : _____

Nr. _____ Prot,

Datë ____/____/____

KONTRATË

PËR

SHËRBIM USHTARAK NË FORCAT E ARMATOSURA

E lidhur ndërmjet palëve:

Grada./Zotit _____, me detyrë _____
(gradë, emër, atësi, mbiemër)

adresë: _____, dhe ushtarakut me:

gradë, _____, banues në adresën: _____,
(emër, atësi, mbiemër)

Me dokument identifikimi nr. _____, titulluar _____ ("oficer", "nënoficer aktiv", "ushtar/detar aktiv"), madhor/e dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

të cilët ranë dakord për sa vijon:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i kontratës

Rregullimi i marrëdhënieve të shërbimit ushtarak në Forcat e Armatosura dhe përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet palëve, ku ushtaraku merr përsipër të ofrojë shërbimin e vet për një periudhë kohe, sipas përcaktimeve të bëra në legjislacionin në fuqi për ushtarakët dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe ato të bëra në këtë kontratë, në interesin dhe nën urdhrat e autoriteteve komanduese ushtarake dhe civile, të cilët marrin përsipër të paguajnë një shpërblim (pagë).

Neni 2

Baza ligjore dhe ligji i aplikueshëm

Kjo kontratë hartohet në bazë të nenit 9, të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Rregullimi dhe interpretimi i saj, do të bëhet në përputhje me legjislacionin shqiptar të aplikueshëm për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë:

Ligjit nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ligjit nr.64/2014, datë 26.6.2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

Ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ligjit nr. 9183, datë 05.02.2004 “Për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ligjit nr. 8003, datë 28.09.1995 “Kodi Penal Ushtarak”, i ndryshuar.

Neni 3

Detyra/funksioni dhe përshkrimi i punës

Ushtaraku do të shërbejë në Repartin Ushtarak Nr. _____, me adresë: _____, me detyrë/funksion (sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e punës) _____.

Në rast se brenda afatit të përcaktuar në nenin 9, të ligjit nr.59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ushtaraku, emërohet në një strukturë tjetër, nga ajo që ka nënshkruar kontratën fillestare, atëherë kontrata fillestare mbetet në fuqi deri në përfundim të afatit. Struktura ku do të emërohet, i paraqet përshkrimin e detyrës në të cilën është emëruar.

Ushtaraku është i detyruar të shërbejë ku ta kërkojnë interesat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 4

Kohëzgjatja e shërbimit

Kohëzgjatja e shërbimit në Forcat e Armatosura është 3 vjet për ushtarët/detarët aktivë dhe nënoficerët dhe 6 vjet për oficerë, me të drejtë ripërtëritje.

Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës për gradën respektive bëhet sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 59/2014, dhe nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14, të këtij ligji;

Neni 5

Koha e punës

Kohëzgjatja normale e punës për personelin ushtarak aktiv të Forcave të Armatosura, përcaktohet sipas akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë kohën e punës dhe të pushimit për ushtarakët e Forcave të Armatosura, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes miraton orarin normal të punës për të gjithë personelin e Forcave të Armatosura, sipas misionit dhe territorit ku kryejnë veprimtarinë.

Për nevoja të domosdoshme të punës, gatishmërisë dhe shërbimit, me urdhër të eprorit, ushtaraku detyrohet të punojë dhe jashtë orarit zyrtar të punës.

Kur e kërkon misioni i njëjësive ose situata operationale, personelit të Forcave të Armatosura i kërkohet të punojë edhe në ditët e pushimit javor dhe festave, pa të drejtë përfitimi ose pagese suplementare.

Kohëzgjatja javore normale e punës do të jetë 40 orë dhe përfshin ditët nga e hëna deri të premten, ndërsa ajo ditore është 8 orë.

Neni 6

E drejta për pushime

Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura gëzon të drejtën e pushimit javor, pushimit vjetor të paguar dhe të pushimeve të tjera të paguara të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore.

Kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar për oficerët, nënoficerët aktivë të Forcave të Armatosura është 45 ditë kalendarike, ndërsa për ushtarët/detarët aktiv është 30 ditë kalendarike.

Kur ushtaraku, për shkak të detyrës, nuk e kryen lejen e pagueshme vjetore, paga për lejen e pakryer i jepet në fund të muajit mars të vitit pasardhës.

Kur ushtaraku, gjatë kryerjes së lejes së pagueshme vjetore, për arsye shëndetësore bëhet i paafte për punë dhe këtë e vërteton me raport mjekësor, njofton vendin e punës dhe pushimi vjetor i zgjatet për atë periudhë kohe.

Ushtaraku aktiv i Forcave të Armatosura, përveç pushimeve të përcaktuara, ka të drejtën e pushimit të paguar edhe për rastet e tjera të paparashikuara, në vendimin nr. 404, datë 19.06.2004 “Për kriteret e dhënies dhe kohëzgjatjen e pushimeve në raste të veçanta, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Ushtaraku i Forcave të Armatosura ka të drejtë që, në raste të veçanta, të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye shëndetësore, personale, për fëmijët, bashkëshortin/en, ose prindërit.

Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara brenda një viti kalendarik sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Ushtaraku duhet të planifikojë paraprakisht periudhat e kryerjes së pushimit të pagueshëm vjetor dhe t’ia paraqesë eprorit, i cili e miraton këtë planifikim, ose mund ta ndryshojë duke marrë paraprakisht mendimin e kërkuesit.

Neni 7

E drejta e pagës dhe përfitime të tjera

Paga mujore e ushtarakut do të jetë sipas përcaktimeve të bëra në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Pagesa do të bëhet në fillim të çdo muaji, nëpërmjet një llogarie bankare rrjedhëse që ushtaraku do të çelë, në një nga bankat e nivelit të dytë, të zgjedhur nga vetë ushtaraku.

Struktura ushtarake është e detyruar të regjistrojë dhe të paguajë çdo muaj kontributet e ushtarakut për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe sigurimet shoqërore suplementare, si dhe të njohë ushtarakun me pagën, me shtesat dhe kontributet e tjera të funksionit organik.

II. TE DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet

Palët e ndërtojnë këtë marrëdhënie në përmbushje dhe respekt të akteve ligjore e nënligjore mbi marrëdhëniet e shërbimit ushtarak dhe me të drejtat e detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë dhe në mirëkuptim mes tyre.

1.1. Detyrimet e strukturës ushtarake :

- a) të respektojë të drejtat e ushtarakut të njohura dhe të mbrojtura nga aktet ligjore dhe nënligjore, rregulloret ushtarake në fuqi, si dhe ndryshimet që ato mund të pësojnë gjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate.
- b) të krijojë kushte optimale, nëpërmjet sigurimit të ambienteve dhe mjeteve që nevojiten për kryerjen sa më mirë të, detyrës;
- c) të respektojë dinjitetin dhe personalitetin e ushtarakut;
- ç) të përmbushë në kohë, sidomos detyrimet që lidhen me dhënien e pagës, derdhjes së kontributeve për sigurim shoqëror e shëndetësor, sigurimet shoqërore suplementare dhe përfitimeve të tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e shërbimit.

1.2. Detyrimet dhe të drejtat e ushtarakut:

1.2.1 Detyra themelore :

Është detyrë e çdo ushtaraku t'i shërbejë Republikës së Shqipërisë me besnikëri dhe ndershmëri, për të mbrojtur të drejtat dhe lirinë e popullit.

Është detyrë e çdo ushtaraku të respektojë rendin kushtetues.

1.2.2. Detyra dhe përgjegjësi :

- a) të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) të ruajë kurdoherë nderin e dinjitetin e ushtarakut;
- c) të shërbejë ku ta kërkojnë interesat e Forcave të Armatosura;

- c) të përgatitet ushtarakisht, të jetë i gatshëm dhe i disiplinuar, për çdo sakrificë, deri në dhënien e jetës për mbrojtjen e atdheut;
- d) të sigurojë për publikun e gjerë, palët e interesuara dhe institucionet publike informacionin e kërkuar, me përjashtim të rasteve kur informacioni është i klasifikuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- dh) të respektojë orarin e punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave.
- e) të rrisë aftësitë profesionale dhe të marrë pjesë në veprimtari trajnuese për këtë qëllim;
- ë) të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim material, për kryerjen e detyrave, me përjashtim të pagës dhe të përfitimeve të tjera, të përcaktuara me ligj e akte të tjera nënligjore;
- f) të mbajë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve të veta, gjatë kryerjes së detyrës;
- g) të zbatojë rregullat e etikës.
- gj) ushtarakët aktivë, pavarësisht nga grada dhe detyra, janë të barabartë para ligjit;
- h) për shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, kërkesave të disiplinës ushtarake, mos ushtrimit të përgjegjësisë e të detyrave dhe për dëme materiale të shkaktuara ndaj pronës publike dhe private, ushtaraku mban përgjegjësi penale, civile, administrative dhe disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- i) detyrohet të kryejë personalisht punën e ngarkuar;
- j) të respektojë urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të strukturës ushtarake;
- k) të ruajë me besnikëri interesat e ligjshme të strukturës ushtarake.

Ushtaraku, përveç detyrave të përcaktuara më sipër, kryen dhe përgjigjet edhe për detyra të caktuara me akte të tjera ligjore, nënligjore, rregullore ose manuale organike, të specifikuara sipas funksionit.

1.2.3. Të drejtat e ushtarakut :

- a) punë të garantuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- b) të përparojë në gradë e në rendin e përgjegjësisë (karrierë), sipas akteve ligjore e nënligjore;
- c) të mbrohet nga shteti në kryerjen e detyrave të ngarkuara;
- ç) të trajnohet, të kualifikohet dhe të ndjekë studimet në institucionet arsimore, ushtarake ose civile, brenda dhe jashtë vendit, vetëm kur i jepet leje, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profesionin;
- d) të ushtrojë të drejtën e besimit dhe veprimtarisë fetare, jashtë territorit të repartit ose institucionit ushtarak dhe pa uniformë ushtarake;
- dh) të shërbejë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në operacione të ndryshme ndërkombëtare, me leje të autoritetit përkatës;
- e) të përdorë veshje civile jashtë kohës së punës e të shërbimit, ose kur e kërkon natyra e shërbimit;
- ë) të organizohet në shoqata, të cilat nuk kanë karakter politik ose sindikalist.

Ushtaraku, përveç të drejtave të përcaktuara më sipër, gëzon edhe të drejta të caktuara me akte të tjera ligjore, nënligjore, të specifikuara sipas funksionit.

Neni 9

Ndalimet për shkak të detyrës ose të shërbimit

Ushtarakut aktiv, për shkak të detyrës ose shërbimit, i ndalohet:

- a) të jetë anëtar i partive politike, i organizatave ose shoqatave me karakter politik, si dhe të marrë pjesë në veprimtaritë politike që organizohen prej tyre;
- b) të bëjë grevë;
- c) të përdorë pronën shtetërore për përfitime vetjake;
- ç) të bëjë pushime ose të shkojë për vizita tek të afërmit e tij jashtë vendit pa marrë leje me shkrim (zbatohen procedurat dhe përcaktimet e bëra në urdhrin përkatës të Ministrit të Mbrojtjes).
- d) gjithashtu i ndalohen edhe veprimtaritë e parashikuara në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 10

Njoftimet

Njoftimet që lidhen me detyrimet e palëve për zbatimin e kësaj kontrate, bëhen sipas rastit me gojë dhe me shkrim.

Njoftimi për zgjidhjen e kontratës, përfundimin ose ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kërkimin e një të drejte, apo përmbushjes së një detyrimi që rrjedh nga kontrata ose ligji, për efekt të njohjes dhe ushtrimit të saj, duhet të bëhen vetëm me shkrim.

III. SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 11

Shkeljet, penalitetet dhe masat disiplinore

Ushtaraku, në rast shkeljeje të ligjeve apo të akteve të tjera nënligjore, përgjigjet penalisht, në mënyrë administrative dhe disiplinore sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar në fuqi.

IV. ZGJIDHJA E KONTRATËS, MOSMARRËVESHJET

Neni 12

Përfundimi dhe zgjidhja e kontratës së shërbimit

Kjo kontratë konsiderohet e përfunduar dhe zgjidhur me përfundimin e afatit të përcaktuar, me daljen në rezervë, ose lirim të ushtarakut.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje e lindur ndërmjet palëve, në lidhje me zbatimin e kushteve të kësaj kontrate, do të paraprihet nga diskutimet për zgjidhjen me mirëkuptim të tyre, në rast të kundërt palët, i drejtohen Gjykatës Administrative në, Tiranë.

Neni 14

Rishikimi i kontratës

Në rast të ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për ushtarakët e Forcave të Armatosura, kontrata do të rishikohet.

Ndryshimet do të bëhen gjithmonë me shkrim dhe të dokumentuara nga palët.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 16

Hartimi dhe nënshkrimi i kontratës

Kontrata u hartua në 3 (tre) kopje autentike, 2 (dy) për strukturën ushtarake dhe 1 (një) për ushtarakun.

Numri i fletëve _____ (_____).

Palët pasi e lexuan, kuptuan përmbajtjen dhe e pranuan, me vullnet të lirë e nënshkruajnë atë.

Nënshkruar në _____, më datë ____/____/_____.

PALËT NËNSHKRUESE

PËR STRUKTURËN USHTARAKE

Komandanti/Drejtori

Grada/zoti Emër / Mbiemër

USHTARAKU

Oficer, nënoficer, ushtar/detar aktiv

Grada Emër / Mbiemër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

Adresa : _____ Telefon : _____ ; Fax : _____
Web site : _____ e-mail : _____

Nr. _____ Prot,

Datë ____/____/____

KONTRATË

PËR

**NDJEKJEN E STUDIMEVE TË LARTA DHE SHËRBIM SI OFICER AKTIV NË
FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPERISE**

Sot, më datë ____/____/____, lidhet kjo kontratë midis palëve:

Komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes _____,
(grada, emër, mbiemër)

dhe **studentit** _____, me adresë:
(emër, atësi, mbiemër)

me letërnjoftim nr. _____, madhor/e dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

për: ndjekjen e studimeve të larta ushtarake/civile, në degën _____, në
institucionin arsimor _____, në _____
(shteti)

për periudhën ____/____/____, deri më ____/____/____, miratuar me urdhër të
Ministrit të Mbrojtjes nr. _____, datë ____/____/____ dhe shërbimin si oficer aktiv pas
përfundimit të studimeve për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritje edhe deri 6
(gjashtë) vjet të tjera.

Me vullnet dhe dëshirë të lire, palët bien dakort për sa më poshtë:

Neni 1

Objekti i kontratës

Ndjekja e studimeve të larta, si dhe shërbimi si “oficer aktiv” në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pas përfundimit të studimeve, për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare, me të drejtë ripërtëritje sipas paragrafit “i”, të shkronjës “c” të nenit 9, të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo kontratë lidhet në baze të ligjit nr.59/2014, datë 12.6.2014 “Për karrierën e ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë” (shkronja “c”, pika 1, neni 9).

Neni 3

Kohëzgjatja e kontratës

Kjo kontratë është e vlefshme për periudhën e studimeve _____ (sasinë e viteve që ka të përcaktuar fakulteti në vendin ku do të kryhet studimit), si dhe për 6 (gjashtë) vite shërbimi si “oficer aktiv në Forcat e Armatosura”, me të drejtë ripërtëritje.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Ministrisë Mbrojtjes

1. Të krijojë, mbi bazën e marrëveshjeve ku do të kryhet arsimimi, të gjitha kushtet e nevojshme për studentët ushtarakë.
2. Të mbulojë shpenzimet financiare për të gjitha detyrimet e përcaktuara sipas marrëveshjes së nënshkruar me shtetet që ofrojnë të drejtën e studimit.
3. Të marrë në fund të çdo viti akademik, si dhe në çdo kohë, nëpërmjet atasheve ushtarakë shqiptarë informacionin e nevojshëm për :
 - ecurinë në përvetësimin e programit nga studentët,
 - mbarëvajtjen dhe performancën,
 - sjelljen dhe figurën si student ushtarak dhe qytetar i vendit tonë,
 - të dhëna të tjera që lidhen me kërkesat akademike të shkollës/akademisë, adresën, numrin e telefonit personal/familjar etj.
4. Të bëjë titullimin “oficer aktiv”, të japë gradën e parë dhe të emërojë në detyrë studentin, menjëherë sapo ka përfunduar arsimimin, vërtetuar me dokumentacionin përkatës në përputhje me specialitetin për të cilën është arsimuar.
5. Të emërojë në detyrë në përshtatje me gradën dhe specialitetin studentët që përfundojnë arsimimin me mesatare mbi 8.5, brenda 2 alternativave që ata kërkojnë të shërbejnë.
6. Në rastet kur studenti është i titulluar oficer gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, nuk do të paguhet, procedura e emërimit në detyrë do të bëhet në përfundim të ciklit të plotë studimeve të programit akademik/universitar.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e studentit

1. Të njihet me kushtet për arsimim në shkollën (akademinë) ku do të studiojë përpara nënshkrimit të kontratës.
2. Të përfitojë shpenzimet financiare për të gjithë periudhën e studimeve të përcaktuara sipas marrëveshjes së nënshkruar me shtetin që ofron të drejtën e studimit.

3. Të pajiset me uniformë ushtarake, grada, shenja dhe simbole që vendosen në uniformë, sipas normave të miratuara, për të gjithë periudhën e studimeve.
4. Të japë në fund të çdo viti akademik, si dhe në çdo kohë informacionin e nevojshëm për :
 - ecurinë në përvetësimin e programit nga studentët,
 - mbarëvajtjen dhe performancën,
 - sjelljen dhe figurën si student ushtarak dhe qytetar i vendit tonë,
 - të dhëna të tjera që lidhen me kërkesat akademike të shkollës/akademisë.
5. Të ndjekë studimet dhe të zbatojë rregulloret e shkollës/akademisë ku arsimohet.
6. Studenti, pas përfundimit të studimeve, brenda 30 ditëve, të paraqitet së bashku me dokumentacionin e plotë në Akademinë e Forcave të Armatosura dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit, në pritje të vijimit të procedurave për titullimin “oficer aktiv”, dhënien e gradës së parë dhe emërimin e tij në detyrë.
7. Studentët që përfundojnë arsimimin jashtë vendit me mesatare mbi 8.5, kanë të drejtë të zgjedhin vendin e punës brenda 2 alternativave të kërkuara, në përshtatje me gradën dhe specialitetin.
8. Studenti, pas titullimit “oficer aktiv”, marrjes së gradës së parë dhe emërimit në detyrë, në përputhje me specialitetin për të cilën është arsimuar, është i detyruar të shërbejë për një periudhë 6 (gjashtë) vjeçare në Forcat e Armatosura, me të drejtë ripërtëritje sipas paragrafit “i”, të shkronjës “c” të pikës 1, të nenit 9, të ligjit 59/2014.
9. Kur studenti, për arsye objektive, nuk përfundon në afatet e miratura studimet (ka lëndë të mbartura), në varësi të marrëveshjes me shtetin që ka nënshkruar marrëveshje, pas miratimit të bërë nga Ministri i Mbrojtjes, kontrata mbetet në fuqi deri në përfundimin e studimeve.
10. Pas përfundimit të studimeve, studenti është i detyruar të kthehet në atdhe.
11. Pas titullimit “oficer aktiv” dhe dhënies së gradës së parë, studenti është i detyruar të shërbejë ku ta kërkojnë interesat e Forcave të Armatosura.
12. Në rast se studenti shkel kontratën (nuk kthehet në atdhe, nuk përfundon studimet, etj), ai i nënshtrohet penaliteteve të parashikuara në nenin 8, të kësaj kontrate.
13. Studenti, i nënshtrohet të gjitha kërkesave të legjislacionit në vendin pritës.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes

1. Të krijojë dhe të plotësojë rregullisht dosjen personale fizike të studentit në dy kopje.
2. Të pajisë me uniformë ushtarake, grada, shenja dhe simbole që vendosen në uniformë, sipas normave të miratuara, për të gjithë periudhën e studimeve.

2. Kjo kontratë pasi u lexua dhe u kuptua, u nënshkrua me vullnetin e lirë e të plotë të palëve, dhe hyn në fuqi në momentin e fillimit të studimeve të studentit.
3. Kjo kontratë hartohet në tre kopje identike me nga (_____) fletë secila, 1 (një) qëndron në sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, 1 (një) vendoset në dosjen personale të studentit dhe 1 (një) i jepet studentit.
4. Studenti mund të kontaktojë me Ministrinë e Mbrojtjes (Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes) në telefonin _____, si dhe me Ambasadën (Atasheun Ushtarak) në vendin pritës për zgjidhjen e problemeve apo përmbushjen e nevojave që lidhen me detyrimet e palëve sipas kësaj kontrate.
5. Gjithë kjo praktike të administrohet dhe të vendoset në dosje dhe të jetë vlerësim për karrierën e tij.

PALËT NËNSHKRUESE

KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

(grada, emër, mbiemër)

STUDENTI

(emër, atësia, mbiemër)

Shtojca nr.2